

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5592
E mërkurë, 3 tetor 2018
çmimi 0.40 €

MASHT-i fillon matjen e performancës së mësimdhënësve



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI | FAQE 4-5

Në këtë periudhë nuk mund të arrihet konsensusi për dialogun

Politologu Ramush Tahiri ka thënë se dialogu Kosovë - Serbi ka ngecur për arsye se në këtë periudhë partitë politike nuk mund të arrijnë konsensus sa i përket krijimit të një platforme të përbashkët në këtë proces. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në një farë forme Kosova ka mbetur në bllokadë ndërkombëtare pasi nuk po mund t'i kryejë obligimet që i ka marrë. Duke folur për qeverisjen në vend, Tahiri ka thënë se pozita nuk i ka votat për të ndenjur në pushtet, por as opozita nuk i ka votat për ta rrezuar Qeverinë. Sipas Tahirit, ky është pat pozicioni i keq që nuk po i bën hair Kosovës. Ai ka thënë se vendi mund të shkojë në zgjedhje të reja këtë vit



Lëvizje të reja në kabinetin qeveritar

As kryeministri Ramush Haradinaj dhe as kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, nuk e kanë pranuar të martën dorëheqjen e ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, të cilën e ka ofruar një ditë më parë. Haradinaj ka thënë se Tahiri ende është ministër, kurse Veseli ka bërë me dije se vendimmarrja për këtë çështje i përket atij dhe PDK-së. Haradinaj, po edhe Veseli, kanë lavdëruar punën e ministrit të Drejtësisë, duke e konsideruar ndër ministrat më të suksesshëm të kabinetit qeveritar. Brenda PDK-së pritet të ketë ndërrim të ministrave në dy ministri të tjera të cilat i udhëheq kjo parti. Këtë e ka konfirmuar kryeministri Haradinaj | FAQE 3



Gashi
kërkon
gjithë-
përfshirje
për
hartimin e
projektligjit
për
diasporën

FAQE 9

AKTUALE



SHTYPI SHQIP I KOSOVËS
PËR PROTESTAT STUDENTORE
TË 1 TETORIT 1997 F. 11

IZET ABDYLI

THAÇI: STABILITETI POLITIK,
PARAKUSHT PËR ZHVILLIMIN
EKONOMIK TË BALLKANIT
PERËNDIMOR F. 3

QEVERIA MIRATON
PROJEKTLIGJIN PËR
MBROJTJE NGA ZHURMA F. 7

RRITET KUFIRI I VJETËRSISË
SË AUTOMJETEVE TË
IMPORTUARA NGA
10 NË 15 VJET F. 7

EKONOMI

MPMS-ja RRIT PËRKRAHJEN
PËR PUNËSIM TË PERSONAVE
ME AFTËSI TË KUFIZUARA F. 8

OEK-u DHE EYE
SYNOJNË THELLIMIN E
BASHKËPUNIMIT MES
SHKOLLAVE PROFESIONALE F. 8

KULTURË

NEXHMIJE PAGARUSHA
BËHET ME STATUS TË
MERITAVE TË VEÇANTA F. 7

SPORT

FERONIKELI NË 'ZAHIR
PAJAZITI' SYNON TA RUAJË
POZITËN E PARË F. 15

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiqi: Me Putinin më së shumti bisedova për Kosovën

MOSKË, 2 TETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë në Moskë, pas takimit me presidentin rus Vladimir Putin, se gjatë bisedës dyorëshe, së paku 45 minuta kanë biseduar për situatën në Kosovë. "Kam folur për situatën, për frikën që kemi në rast se provokimet vazhdojnë dhe në rast se do të kemi çfarëdo sulmesh në jetët dhe

pronën e popullit serb në Kosovë", u ka thënë Vuçiqi gazetarëve pas këtij takimi. Ai nuk dhënë më shumë detaje nga përmbajtja e takimit pasi, siç ka thënë, pse atëherë do të duhej të bisedonte në katër sy me presidentin rus Putin. I pyetur nëse Putini është njoftuar me planin për "korrigjim të kufijve", Vuçiqi ka thënë se nuk ka çfarë të

flitet për një plan që e kanë refuzuar vendet e BE-së, serbët dhe shqiptarët. "Kam menduar se ajo është një zgjidhje racionale, por askush tjetër nuk mendon kështu", u shpreh Vuçiqi. Presidenti Vuçiq deklaroi se presidentin rus e ka falënderuar për mbështetjen që Rusia ia ofron Serbisë në forumet ndërkombëtare.



Grupi për Studime Juridike dhe Politike ka organizuar tryezën "Dialogu Kosovë-Serbi: Rrugë e gjatë deri te marrëveshja?"

Për territorin mund të vendosë vetëm Kuvendi

Njohësit e së Drejtës kushtetuese dhe përfaqësuesit e subjekteve politike kanë vlerësuar se Kuvendi duhet të ketë rol kyç në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Në tryezën "Dialogu Kosovë - Serbi: Rrugë e gjatë deri te marrëveshja?", ata kanë thënë se çdo marrëveshje e arritur në këtë proces duhet të ratifikohet në Kuvend me dy të tretat e votave. Sipas tyre, Kuvendi është i vetmi institucion në vend që mund të vendosë për integritetin territorial të Kosovës

"Epoka e re"

PRISHTINË, 2 TETOR - Njohësit e të Drejtës kushtetuese dhe përfaqësuesit e subjekteve politike kanë bërë me dije se vetëm Kuvendi i Kosovës mund të vendosë për territorin e Kosovës nëse kjo gjë vjen në shprehje në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi. Në tryezën "Dialogu Kosovë - Serbi: Rrugë e gjatë deri te marrëveshja?", të organizuar nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, ata kanë deklaruar se çdo marrëveshje e arritur në këtë fazë të dialogut duhet të ratifikohet me dy të tretat e votave në Kuvend. Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, Enver Hasani, duke folur për rolin kushtetues të shefit të shtetit në

Kosovë, krahasuar me pozitën dhe rolin e shefit të shtetit në të gjitha vendet e tjera parlamentare, ka thënë se çështja e sovranitetit kombëtar dhe territorit i takojnë Kuvendit të Kosovës. "Çështja e sovranitetit kombëtar dhe territorial u takojnë ekskluzivisht përfaqësuesve të sovranit, Kuvendit të Kosovës. E dyta, asnjë organ i Kosovës, veç përfaqësuesve të sovranit, nuk ka të drejtë apo mandat të negociojë apo të nënshkruajë ndonjë marrëveshje ndërkombëtare që prek çështjet nga nen 10.1 i Kushtetutës. E treta, çështjet nga neni 18.1 i Kushtetutës së Kosovës prekin thelbin e identitetit kushtetues dhe kombëtar të Kosovës, sovranitetin dhe integritetin territorial që çdoherë dhe në çdo fazë kërkon shu-



micën e votës prej dy të tretave të të gjithë deputetëve të sovranit", ka thënë Hasani. Arsim Bajrami, profesor i së Drejtës kushtetuese, ka thënë se është një gjë e mirë, se askush nuk kundërshton që të ketë një marrëveshje me Serbinë. Sipas tij, kundërshtohet vetëm formati i këtij procesi. "Tani Kushtetuta e Kosovës ka vendosur kufizimet sa i përket arritjes së marrëveshjeve ndërkombëtare. Presidenti e di se arritja e çdo marrëveshje duhet të ratifikohet në Kuvend. Të drejtën ekskluzive për arritjen

e një marrëveshjeje finale e ka Kuvendi i Kosovës", ka deklaruar Bajrami. Kurse Avdullah Hoti, shef i Grupit Parlamentar i LDK-së, beson se çështjet e hapura në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të mbyllet vetëm përmes dialogut. "Besojmë se në këtë proces nuk duhet të hyjmë vetëm. Jemi të interesuar të përfundojmë sa më shpejt, por jo në dëm të Kosovës. Kemi nevojë të arrijmë marrëveshje, por jo çfarëdo marrëveshje. Rrethanat aktuale e kanë pamundësuar një dialog substancial. Ne jemi

kundër idesë për korrigjim të kufijve. Korrigjimi i kufijve është korrigjim edhe i Deklaratës së Pavarësisë. Ne besojmë se marrëveshja me Serbinë duhet të sjellë njohje dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare", është shprehur Hoti.

Edhe shefi i Grupit Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, ka insistuar që në këtë proces rol kyç të ketë Kuvendi i Kosovës. Sipas tij, ekziston një rezolutë që përcakton kush duhet të shkojë në dialog. "Presidenti ka dalë në skenë një ditë dhe ka thënë se unë dua ta bëj dialogun me Serbinë, ndërsa situata juridike është rezoluta që është në fuqi. Edhe nëse kryeministri po dëshiron t'ia kalojë mandatin presidentit nuk mund ta bëjë duke e anashkaluar Kuvendin. Nuk ka qenë në rregull, kryeministri. Në Kosovë figurat politike janë shumë më të forta sesa politika. Tema që e ka ngritur presidenti është shumë e rëndësishme. Çështja e kufijve është elementi kryesor i shtetit", ka thënë Konjufca.

Në këtë tryezë kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e tjerë të partive parlamentare.

Meta: ShBA-ja, partnerja jonë strategjike

TIRANË, 2 TETOR - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka vazhduar vizitën zyrtare në ShBA. Së fundmi ai është pritur nga senatori i Missouriit, Roy Blunt, njëkohësisht zëvendëskryetar i Konferencës së Senatorëve Republikanë. "ShBA-ja është partnerja jonë strategjike, ndaj forcimi i mëtejshëm i këtyre marrëdhënieve është i një rëndësie vitale për ne", theksoi presidenti

Meta. "Angazhimi i ShBA-së në rajonin tonë mbetet kyç edhe për të ardhmen, në mënyrë që të konsolidohen arritjet e deritanishme si në drejtim të stabilitetit e sigurisë, po ashtu edhe të përparimit të demokracisë e të prosperitetit. Ndaj ne mbështesim fuqishëm politikën e detyrë të hapura të NATO-s dhe, pas anëtarësimit të Malit të Zi, vlerësojmë se edhe anëtarësimi i

Maqedonisë në NATO do të ishte një arritje tepër pozitive për të ardhmen e të gjithë rajonit tonë", u shpreh presidenti Meta. Në këtë drejtim të dy bashkëbiseduesit shprehën dëshirën që Parlamenti i Maqedonisë t'i marrë përgjegjësitë e duhura përmes bashkëpunimit për t'iu përgjigjur aspiratës legjitime të shumicës së qytetarëve për anëtarësim në NATO e BE.



Lëvizje të reja në kabinetin qeveritar

As kryeministri Ramush Haradinaj dhe as kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, nuk e kanë pranuar të martën dorëheqjen e ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri, të cilën e ka ofruar një ditë më parë. Haradinaj ka thënë se Tahiri ende është ministër, kurse Veseli ka bërë me dije se vendimmarrja për këtë çështje i përket atij dhe PDK-së. Haradinaj, po edhe Veseli, kanë lavdëruar punën e ministrit të Drejtësisë, duke e konsideruar ndër ministrat më të suksesshëm të kabinetit qeveritar. Brenda PDK-së pritet të ketë ndërrim të ministrave në dy ministri të tjera të cilat i udhëheq kjo parti. Këtë e ka konfirmuar kryeministri Haradinaj

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 3 TETOR - Edhe një ditë pasi ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka ofruar dorëheqje, ajo nuk është pranuar nga kryeministri Ramush Haradinaj. Dorëheqja e Tahirit nuk është pranuar as nga kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli. I pari dhe i dyti kanë deklaruar se vendimi për pranimin e kësaj dorëheqjeje i takon PDK-së.

Në një konferencë për medie, pas mbledhjes së Qeverisë, kryeministri Haradinaj ka thënë se Tahiri ende vazhdon të jetë ministër i Drejtësisë. "Abelardi është ende ministër. Dorëheqja e tij ende nuk është definitive. Unë dje nuk e kam pranuar dorëheqjen e tij. Kam pritur të konsultohem me kryetarin e PDK-së, z. Veseli. Ashtu si të vendos PDK-ja do të ndodhë", ka thënë Haradinaj. Madje kreu i ekzekutivit ka lavdëruar punën e deritashme të Tahirit, duke shpresuar se PDK-ja të vazhdojë edhe më tutje t'i

besojë këtij ministri. "Ju siguroj se Abelardi është ministër i respektuar në Qeveri dhe për emra të tjerë nuk di, për besë. Ka pasur shumë spekulime, por është në të drejtën e PDK-së të bëjë propozime të reja. Kështu ka ndodhur edhe te partitë e tjera, te AKR-ja, te Nisma, pse jo edhe te PDK-ja. Unë do t'i respektoj propozimet e tyre", është shprehur Haradinaj. Për ta diskutuar këtë çështje, lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka mbledhur të martën një pjesë të Kryesisë së PDK-së, por nuk kanë marrë ndonjë vendim.

Pas mbledhjes, Veseli ka lavdëruar punën e ministrit Tahiri dhe ka thënë se vendimmarrja për këtë çështje i përket atij dhe PDK-së. Sipas tij, vendimmarrja për këtë rast nuk i takon vetëm ministrit Tahiri. "Unë e kam takuar ministrin e Drejtësisë pak më herët. Është një nga ministrat që ka bërë një punë shumë të guximshme, duke ndërmarrë reforma në drejtësi dhe nuk ka asnjë aferë korruptive. Jam i njoftuar me sit-



Totaj dhe Çoçaj mund të jenë ministrat e rinj të PDK-së

Rrugën e ministrit Tahiri pritet ta ndjekin edhe dy ministra të tjetër të PDK-së, por kjo nuk dihet nëse ata kanë ofruar dorëheqje apo do ta lirojnë pozitën në koordinim me kryetarin e partisë. Burime të gazetës "Epoka e re" brenda PDK-së thonë se në Ministrinë e Financave, të Inovacionit dhe të Kulturës mund vijnë emra të rinj nga kjo parti. Sipas këtyre burimeve, Shaqir Totaj, ish-kandidat i PDK-së për kryetar të Prizrenit, mund ta marrë detyrën e ministrit në njërin prej këtyre tri ministrave si dhe ish-deputeti i këtij subjekti politik, Nezir Çoçaj, i cili para pak kohe ka dhënë dorëheqje nga

pozita e përfaqësuesit të popullit. "Këta dy emra po përliften si ministra të mundshëm të ardhshëm të PDK-së", kanë thënë burimet e gazetës.

Ish-kandidati i PDK-së për kryetar të Prizrenit, Shaqir Totaj, ka shprehur të martën gatishmërinë e tij për ta zënë pozitën e njërit prej partiakëve të tij që janë ministra.

Kryeministri Haradinaj për televizionin T7 pati deklaruar se PDK-ja do të bëjë ndryshime të ministrave në tri ministri që udhëheq. Lëvizje të ministrave në Qeverinë Haradinaj ka pasur edhe më herët. Fillimisht, AKR-ja ka liruar nga detyra ish-ministren

e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Albena Reshitaj, për ta emëruar u. d. të ministrit Fatmir Matoshin. Pastaj shkarkimi i ministrit të Punëve të Brendshme, Flamur Sefaj, për t'u zëvendësuar më pas me Bejtush Gashin. Tani Nisma ka emëruar Endrit Shalën ministër të Tregtisë dhe të Industrisë, në vend të Bajram Hasanit, të cilin më herët e kishte liruar nga kjo detyrë. Pavarësisht prej këtyre lëvizjeve në kabinetin qeveritar, kryeministri Haradinaj ka mohuar se kjo tregon brishtësi të Qeverisë së tij. Haradinaj ka thënë se Qeveria e tij është stabile dhe është duke e realizuar agjendën e paraparë.

uatën në të cilën ai ndodhet, po vendimmarrja është e imja. Nuk ka vendimmarrje e cila do të mund të ndodhë nga individë në

PDK. Vendimmarrja do të jetë e imja dhe e Partisë Demokratike të Kosovës", ka deklaruar Veseli. Kryetari i PDK-së ka bërë me dije

se dorëheqjet individuale nuk mund të ndodhin përderisa partia dhe ai si kryetar të mos vendosin nëse do t'i miratojnë ato.

Thaçi: Stabiliteti politik, parakusht për zhvillimin ekonomik të Ballkanit Perëndimor

GJENEVË, 2 TETOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë në "Dialogun strategjik për Ballkanin Perëndimor - takimi i liderëve", të organizuar nga Forumi Ekonomik Botëror në Gjenevë të Zvicrës, ku ka folur rreth nevojës për të arritur stabilitet politik, duke e vlerësuar këtë edhe si "çelës" për zhvillimin ekonomik të rajonit.

Presidenti Thaçi ka thënë se po punohet për arritjen e një marrëveshjeje paqësore me Serbinë përmes dialogut në Bruksel. "Stabiliteti politik prodhon edhe zhvillim ekonomik, prandaj edhe ne po punojmë për arritjen e një marrëveshjeje ndërshtetërore që stabilizon tërë rajonin tonë", ka

thënë presidenti Thaçi.

Në Forumin Ekonomik Botëror, Thaçi ka thënë se është avantazh që të dyja palët janë në favor të arritjes së kësaj marrëveshjeje dhe e tërë bashkësia ndërkombëtare, ShBA-ja dhe BE-ja, e përkrahin arritjen e saj. "Nuk duhet të paragjykohet rezultati, por të gjithë duhet të jemi unikë për përkrahje të procesit të dialogut Kosovë - Serbi", u shpreh presidenti Thaçi.

Pjesëmarrësit në këtë takim të mbyllur i përkrahën përpjekjet për të ndërtuar stabilitet politik në Ballkanin Perëndimor, si parakusht edhe për zhvillim, tërheqje të investimeve të huaja dhe rritje ekonomike.



Flet për "Epokën e re", Ramush Tahiri

Në këtë periudhë nuk mund të a



Politologu Ramush Tahiri ka thënë se dialogu Kosovë - Serbi ka ngecur për arsye se në këtë periudhë partitë politike nuk mund të arrijnë konsensus sa i përket krijimit të një platforme të përbashkët në këtë proces. Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në një farë forme Kosova ka mbetur në një bllokadë ndërkombëtare pasi nuk po mund t'i kryejë obligimet që i ka marrë. Duke folur për qeverisjen në vend, Tahiri ka thënë se pozita nuk i ka votat për të ndenjtur në pushtet, por as opozita nuk i ka votat për ta rrëzuar Qeverinë. Sipas Tahirit, ky është pat pozicioni i keq që nuk po i bën hair Kosovës. Ai ka thënë se vendi mund të shkojë në zgjedhje të reja këtë vit

EPOKA E RE**Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 2 TETOR - Politologu Ramush Tahiri ka thënë se, pavarësisht prej disa pikave të përbashkëta në mes të spektrit politik në këtë periudhë, është e pamundur arritja e konsensusit dhe krijimi i një platforme të përbashkët për dialogun me Serbinë. Megjithatë, ai ka thënë se Kuvendi nuk mund t'ia marrë të drejtën kushtetuese presiden-

tit Thaçi për të dialoguar dhe për të arritur marrëveshje, por vetëm mund t'ia rrëzojë marrëveshjen e arritur. Sipas Tahirit, kundërshtimet dhe kritikrat që po bëhen në këtë drejtim janë të kota. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka vlerësuar se dialogu në nivel të presidentëve mund të vazhdojë meqë për këtë nuk ka nevojë për autorizim të Kuvendit.

Tahiri ka sqaruar se autorizimi i Kuvendit vlen për Qeverinë dhe

për dialogun teknik. Ndërsa duke folur për funksionimin e koalicionit qeverisës, ai ka thënë se Qeveria aktuale mezi i siguron votat në Kuvend dhe nuk ka një platformë të përbashkët ndërmjet partnerëve të koalicionit duhet të rrëzohet ose të japë dorëheqje. Sipas Tahirit, mospajtime në mes të kryeministrit dhe presidentit për çështje madhore mund ta çojnë vendin në zgjedhje të reja në nëntor.

"Epoka e re": Z. Tahiri, si i komentoni zhvillimet e fundit në skenën politike, përkatësisht ofrimin e dorëheqjes së ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri? Mund të jetë ky indikacion për prishjen e koalicionit qeverisës?

Tahiri: Konsideroj se kjo Qeveri, e cila mezi i siguron votat në Kuvend dhe nuk ka një platformë të përbashkët ndërmjet partnerëve të koalicionit, duhet të rrëzohet ose të japë dorëheqje, për arsye se të gjitha proceset kanë ngecur dhe në kohët e fundit kemi mospajtime në mes të kryeministrit dhe presidentit në çështje madhore. Edhe në mes të partnerëve të koalicionit kemi mospajtime dhe në këto rrethana nuk shoh arsye për të vazhduar mandati i Qeverisë Haradinaj. Madje mendoj se është veç çështje ditësh që Qeveria të hyjë në votëbesim dhe të rrëzohet. Edhe po të mos rrëzohet kjo Qeveri nuk po mund të kryejë asnjë punë dhe nuk e ka përkrahjen e popullit. Populli nuk po e ndien që është një

Qeveri e cila mund të rrijë në këmbë të veta dhe që e kah përkrahjen e 61 deputetëve në Kuvend.

"Epoka e re": Sipas mendimit tuaj, koalicioni qeverisës nuk do të ketë jetëgjatësi?

Tahiri: Jo, madje mendimi im është që mund të rrëzohet këtë të enjte.

"Epoka e re": Si është e mundur një gjë e tillë?

Tahiri: Sepse LDK-ja është duke i mbledhur nënshkrimet dhe së bashku me LV-në i kanë plotësuar kushtet për votëbesimin e Qeverisë dhe ky votëbesim mund të hyjë në Kuvend për 24 orë apo 48 orë varet se si përcaktohet Kryesia e Kuvendit në votim. PDK-ja në këtë koalicion nuk është duke i realizuar vijat e veta programore, ndonëse është partia më e madhe në koalicionin qeverisës, prandaj mund ta mbështetë shpërndarjen e Kuvendit. Nëse me 80 vota shpërndahet Kuvendi atëherë brenda 40 ditëve mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme.

Arrihet konsensusi për dialogun



"Epoka e re": Ju mendoni se PDK-ja do të votojë pro rrëzimit të Qeverisë apo shpërndarjes së Kuvendit?

Tahiri: Mendoj se kjo Qeveri do të rrëzohet këtë javë ose javën e ardhshme. Edhe pa rrëzimin e kësaj Qeverie vendi shkon në zgjedhje me shpërndarje të Kuvendit. Kësisoj në nëntor mund të ketë zgjedhje, sepse me këtë kundërshtim në mes të kryeministrit dhe presidentit vendi nuk mund të ecë përpara, prandaj duhet të bjerë njeri ose tjetri. Presidenti nuk mund të shkarkohet pa plotësimin e tri kushteve që i parasheh ligji. Dhe, duke pasur parasysh se presidenti nuk mund të shkarkohet, atëherë më e lehtë është të bjerë Qeveria ose të shpërndahet Kuvendi dhe vendi të shkojë në zgjedhje, në mënyrë që të krijohet legjitimiteti i ri. Të formohet një koalicion i ri i cili mundëson harmonizim në mes të presidentit dhe partnerëve të koalicionit për ta vazhduar dialogun me Serbinë. Dialogu ka ngecur edhe sa i përket anës teknike, nuk është krijuar Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe dhe në një farë forme Kosova ka mbetur në një bllokadë ndërkombëtare, sepse nuk po mund t'i kryejë obligimet që i ka marrë. Pozita nuk i ka votat për të ndenjur në pushtet, por as opozita nuk i ka votat për ta rrëzuar Qeverinë, prandaj ky është ai pat pozicioni i keq që nuk po i bën hair Kosovës.

"Epoka e re": Sa është e përshatshme për partitë politike, sidomos për këto që janë në pushtet, shkuarja në zgjedhje?

Tahiri: E përshatshme shkuarja në zgjedhje nuk është për PSD-në dhe për LV-në. Nëse është e vërtetë që ka përçarje në mes të Kadri Veselit dhe Hashim Thaçit, atëherë PDK-ja mund ta ketë fatin e LDK-së në kohën e Sejdiut dhe të Dacit. Nëse ministrat e përfolur japin dorëheqje se ka konflikt në mes të Thaçit dhe Veselit, shoh fillimin e fundit të PDK-së në skenë.

"Epoka e re": Pavarësisht prej mospajtimeve në mes të spektrit politik, si e shihni ecurinë e procesit të dialogut me Serbinë?

Tahiri: Dialogu teknik duhet të zhvillohet meqë janë shumë tema të cilat duhet të realizohen, sepse janë në interes të qytetarëve të Kosovës dhe atyre të Serbisë, kurse dialogun në nivel të presidentëve askush nuk mund ta pengojë sepse është e drejtë kushtetuese. Thaçi dhe Vuçiqi kanë të drejtë t'i përfaqësojnë vendet e tyre brenda dhe jashtë si dhe të zhvillojnë dialog apo edhe të arrijnë marrëveshje. Është keqkuptuar një gjë, Kuvendi nuk mund t'ia marrë të drejtën presidentit Thaçi për të dialoguar dhe për të arritur marrëveshje, por vetëm mund t'ia rrëzojë marrëveshjen e arritur. Kundërshtimet dhe kritikën që po bëhen në këtë drejtim janë të kota. Dialogu në nivel të

presidentëve mund të vazhdojë, sepse për këtë nuk ka nevojë për autorizim të Kuvendit. Autorizimi i Kuvendit vlen për Qeverinë dhe për dialogun teknik. Dialogu politik duhet të përfundojë me një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe pjesë e saj do të jetë çështja e kufirit. Tash a do të jetë kufi i ri, i vjetër apo do të jetë një kufi korrektim, kjo do të përcaktohet në marrëveshje sipas vullnetit të palëve.

"Epoka e re": Pavarësisht prej kritikave dhe kundërshtimit, Thaçi po bën thirrje për arritjen e një konsensusi dhe krijimin e një platforme të përbashkët për procesin e dialogut. Në këto rrethana, sa ka gjasa të arrihet një gjë e tillë?

Tahiri: Jo, nuk besoj se mund të arrihet konsensusi dhe të krijohet një platformë e përbashkët për dialogun në këtë periudhë. U mbajtën disa tryeza politike dhe asnjëherë nuk u nxorën idetë e përbashkëta në mënyrë që të hartohet platforma. Megjithatë, janë disa pika të përbashkëta me të cilat pajtohen të gjithë, por nuk po duan ta bëjnë një gjë të tillë. Janë bërë koalicione joparimore vetëm sa për ta mbajtur pushtetin. Lista Serbe nuk pajtohet me asnjë parti, po ashtu edhe anasjelltas. Prandaj, duhet të priset koalicioni dhe të shkohet në zgjedhje të reja. Por, në zgjedhje nuk duhet të shkohet me koalicione parazgjedhore, mirëpo duhet të matet secila parti politike veç e veç.

Ministri Gashi: Gjendja e sigurisë në Kosovë, stabile

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka raportuar të martën në Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë fjalës së tij, ministri Gashi ka theksuar të gjithë punën e bërë deri tani nga ministria që drejton si në fushën e sigurisë, po ashtu edhe për hartimin e strategjive dhe për plotësimndryshimin e disa projektligjeve të cilat pritet të përfundohen deri në fund të vitit. Po ashtu, ministri Gashi ka thënë se gjendja e sigurisë në Kosovë është mjaft stabile dhe se po punohet që të ruhet ky stabilitet për marrjen e masave për parandalimin e cenimit të mundshëm të sigurisë. Në diskutimet në mes të ministrit dhe deputetëve u hap temë

debati sfidat dhe problemet me të cilat po përballet shërbimi i zjarrfikësve në Kosovë. U kërkua të definohet sa më shpejt statusi i zjarrfikësve dhe të sigurohet buxheti i mjaftueshëm për ngritjen e pagave të këtij sektori mjaft të rëndësishëm të sigurisë, si dhe të tregohet kujdes i veçantë për këtë kategori.

Ministri Gashi ka thënë se ka dhjetë vjet që diskutohet për këtë çështje dhe se ende janë në procedurë e sipër dokumentet për rregullimin e kësaj çështjeje, nëpërmjet të cilave shërbimi i zjarrfikësve mos të jetë më në kompetencë të ministrisë, por të komunave.

Në takim u diskutua edhe për projektligjin për pensionin e parakohshëm të policëve. Ministri konstatoi se ministria është në proces të draftimit të



këtij ligji. Po ashtu, pati edhe diskutime të ndryshme nga grupet punuese të komisionit, lidhur me sigurinë në komunika-

cion, reformat në polici, për rekrutimin e policëve të rinj, zbatueshmërinë e ligjit për inspektoratin, si dhe për sigur-

inë e qytetarëve të Kosovës në përgjithësi dhe për përmirësimin e kushteve për kategori të ndryshme.

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, mban konferencë për media

MAShT-i fillon matjen e performancës së mësimdhënësve

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka bërë me dije të martën se rreth 217 mësimdhënës janë përzgjedhur në fazën e parë për matjen e performancës. Ai ka thënë se vlerësimi i performancës së mësimdhënësve ka për qëllim ngritjen e cilësisë në arsimin parauniversitar në Kosovë



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 2 TETOR - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka shpallur të martën detaje rreth procesit të Vlerësimit të Performancës së Mësimdhënësve (VPM) dhe përgatitjeve që janë bërë për ta filluar këtë proces të rëndësishëm në arsimin parauniversitar. "Ashtu sikur edhe jemi zotuar, janë bërë të gjitha përgatitjet dhe tashmë është bërë edhe përzgjedhja e parë e mësimdhënësve që do t'u bëhet matja e performancës", ka theksuar ministri Bytyqi në një konferencë me gazetarë, ku ka folur rreth kornizës strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve, si dokumenti zyrtar i miratuar në prill të vitit të kaluar, e që i ka paraprirë këtij procesi. Ai ka thënë se qëllimi i vlerësimit të performancës së mësimdhënësve është të ngrihet cilësia në arsimin parauniversitar në Kosovë prandaj, sipas kësaj kornize, të gjithë mësimdhënësit duhet të kenë një përgatitje të lartë të secilës lëndë, të cilën mësimdhënësit e paraqesin para nxënësve të tyre.

Ministri Bytyqi më pas ka sqaruar se korniza është e ndërtuar në bazë të katër fushave dhe shtatë standardeve të cilat duhet t'i plotësojnë mësimdhënësit. "Duke qenë se jemi në fazën fillestare, janë përzgjedhur shkollat e para ku do të fillojë matja e performancës si dhe një numër i caktuar i mësimdhënësve. Pra, për këtë fazë është paraparë që numri i mësimdhënësve të jetë rreth 217", ka thënë ai.

Ministri Bytyqi ka theksuar se matja e performancës do t'i ketë katër komponentë kryesorë të cilët do të ndahen në dy grupe që ka të bëjnë me matjen e performancës së brendshme dhe dy të tjera për matjen e performancës së jashtme të cilat së bashku do të japin matjen e plotë të performancës.

Pas matjes së performancës, mësimdhënësit do të vlerësohen në katër grupe. Pra, mund të jenë mësimdhënës të shkëlqyer, të mirë, të kënaqshëm dhe të pakënaqshëm. Ministri ka thënë se nëse mësimdhënësi mund të jetë i pakënaqur me vlerësimin e performancës, atëherë mund të parashtrijë ankesë te Paneli i Artë, i cili formohet në bazë të


Ligjit të ri të Inspektoratit dhe është vendimi i fundit ekzekutiv. Ministri Bytyqi u zotua se MAShT-i do ta përkrahë dhe do të jetë pranë Inspektoratit të Arsimit dhe pranë shkollave dhe DKA-ve, në mënyrë që matja e vlerësimit të performancës të

japë rezultatet e pritura. "Besoj se ky është një lajm i mirë për mësimdhënësit, për nxënësit dhe të gjitha shkollat, sepse qëllimi primar i këtij procesi është që nxënësit t'i fitojnë kompetencat dhe dijen e nevojshme dhe për t'u realizuar kjo, së pari duhet që

mësimdhënësit ta kenë kompetencën në nivelin e duhur, pra të kenë zhvillim profesional të vazhdueshëm", ka deklaruar ministri Bytyqi. Për ta kryer me sukses këtë proces, MAShT-i po planifikon edhe rritjen e numrit të inspektorëve.

Projekti i British Councilit, i nevojshëm për arsimin në Kosovë

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - "Arsimimi i duhur i gjeneratave të reja në vend është objektiv i Qeverisë së Kosovës dhe projektet që kanë të bëjnë me këtë fushë do ta kenë mbështetjen time", kështu ka thënë të martën kryeministri Ramush Haradinaj, pas pritjes së Angus Bjarnsonit, drejtor në detyrë në British Council në Kosovë dhe Shqipëri. Në këtë takim u bisedua për projektin "Shkollat e shekullit 21", projekt ky që është lansuar në Kosovë vitin e kaluar dhe i cili ka për qëllim t'i trajnojë mësimdhënësit e vendit për temat si mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve, të mësuarit digjital dhe përdorimi i pajisjes mikrobit. "Ne jemi



munduar ta përkrahim çdo nismë që ka për qëllim ta avancojë gjendjen e arsimit në vend. Në këtë fushë projekti i British Councilit është tejet i nevojshëm dhe ju falënderojmë për këtë", ka thënë Haradinaj. Pajisja mikrobit, pjesë e projektit "Shkollat e shekullit 21", është pajisje për kodim e zhvilluar nga Microsoft dhe BBC e cila është përdorur në shkollat e Britanisë së Madhe para dy vjetëve. Në Kosovë ky projekt është lansuar vitin e kaluar në dhjetë shkolla, momentalisht është duke u implementuar në dhjetë shkolla të tjera në fazën e dytë derisa faza e ardhshme do t'i përfshijë të gjitha shkollat në Kosovë.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Qeveria miraton Projektligjin për mbrojtje nga zhurma

Projektligji për mbrojtje nga zhurma sqaron rregullat dhe kushtet për përgatitjen e hartave strategjike të zhurmës dhe planin e informimit të publikut. Projektligji është i pajisur me shtojcat që paraqesin indikatorët e zhurmës, metodat e vlerësimit dhe ndikimit të dëmshëm të zhurmës



jnë aftësimin profesional si dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara", është thënë në vazhdimin e komunikatës së Qeverisë.

Gjithashtu, kabineti qeveritar ka miratuar vendimin me të cilin ka emëruar Lum Mitën udhëheqës të Divizionit për Bashkëpunim

Ndërkombëtar Financiar në Ministrinë e Financave, në pozitën e përfaqësuesit të Republikës së Kosovës në Këshillin Administrativ të Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës. Po ashtu, anëtarët e kabinetit qeveritar janë informuar edhe për procesin e realizimit të pagesës së orëve shtesë të Policisë së Kosovës.

Ministri i Punëve të Brendshme, Bejtush Gashi, ka njoftuar kabinetin qeveritar me situatën e krijuar nga nevoja e operacioneve për angazhim të zyrtarëve policorë me orar të zgjatur dhe pamundësia për t'i kompensuar orët shtesë me kohë të lirë për shkak të nevojës së ruajtjes së efikasitetit dhe efektivitetit të funksionimit të Policisë së Kosovës.

Ministri ka bërë me dije se MPB-ja do të përgatisë një analizë të kostos së kompensimit të orëve shtesë të policisë dhe do ta sjellë për aprovim në Qeverinë e Kosovës.

Në mbledhjen e së martës të kabinetit qeveritar janë miratuar në parim dy nisma për lidhjen e marrëveshjeve për plotësimin dhe ndryshimin e marrëveshjeve financiare IPA 2012 dhe IPA 2013.

Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, do t'i ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të marrëveshjeve.

Ndërkohë, me kërkesë të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë janë ndarë mjete financiare për ta mbështetur Gjimnazin "LOYOLA" me 308 mijë euro dhe Shkollën Profesionale "LOYOLA" me 350 mijë euro.

Ministri i Administratës Publike, Mahir Jaghillar, ka prezantuar kërkesën e komunitetit turk që kuota e kalimit të testit për praninë në Policinë e Kosovës për pjesëtarët e komunitetit turk të ulet nga 70 për qind në 50 për qind. Qeveria ka miratuar rekomandimin për Policinë e Kosovës që t'i shqyrtojë mundësitë për krijimin e kushteve më të favorshme për pranimin e pjesëtarëve të komuniteteve në Policinë e Kosovës. Po ashtu, Ministria e Financave ka propozuar ndarjen e mjeteve financiare për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, me qëllim të mbështetjes së funksionimit të rregullt të disa prej ndërmarrjeve publike që aktualisht gjenden në pozitë të pafavorshme financiare.

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 2 TETOR - Kabineti qeveritar në mbledhjen e së martës ka miratuar Projektligjin për mbrojtje nga zhurma, i cili do ta krijojë përputhshmërinë me direktivat e Parlamentit Evropian. Ky projektligj do të jetë më i zbatueshëm sepse bën ndarjen e përgjegjësiave për zbatimin e tij nga komunat dhe përgjegjësit e institucioneve për zbatim.

Projektligji detajon rregullat dhe kushtet për përgatitjen e hartave strategjike të zhurmës dhe planin e informimit të publikut. Projektligji është i pajisur me shtojcat që paraqesin indikatorët e zhurmës, metodat e vlerësimit dhe ndikimit të dëmshëm të zhurmës.

Aprovimin e kabinetit qeveritar e ka marrë edhe Projektligji për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës. Aktualisht në Kosovë përgatiten të dhëna hapësinore nga shumë institucione nga lëmenj të ndryshëm. Këto të dhëna përgatiten në formate të ndryshme dhe shpesh ka vështirësi në këmbimin dhe përdorimin e tyre. "Prandaj, është shumë e nevojshme që të dhënat kryesore që krijohen nga institucionet e ndryshme të sistemohe në një bazë të të dhënave që do ta përbëjnë infrastrukturën kombëtare të të dhënave hapësinore për Republikën e Kosovës", është theksuar në komunikatën e Qeverisë.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe Rregulloren për lehtësirat doganore dhe tatimore për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara si dhe për personat me aftësi të kufizuara që ushtrojnë veprimtari të pavarur. "Më herët nuk ka pasur ndonjë akt juridik që ka rregulluar këtë çështje, ndërsa Ligji për aftësimin dhe riaftësimin profesional si dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara ka krijuar bazën ligjore për rregullimin dhe përcaktimin e këtyre lehtësirave. Përveç kësaj Rregulloreje, janë në proces të hartimit edhe disa akte të tjera nënligjore të cilat do ta promovojnë

Nexhmije Pagarusha bëhet me status të meritave të veçanta

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka bërë me dije se pas propozimit të tij, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që nga e marta Nexhmije Pagarusha do ta ketë statusin e qytetares me merita të veçanta për shkak të kontributit të saj në promovimin e muzikës së mirëfilltë shqipe. Po me këtë vendim Pagarusha do të mbështetet financiarisht me nga 500 euro në muaj. "Nexhmije Pagarushës i njihet statusi i qytetares me merita të


veçanta për kontributin e saj në promovimin e muzikës së mirëfilltë shqipe, duke përfshirë edhe mbështetjen financiare të saj siç është përcaktuar në propozim-vendim në vlerë prej 500 eurosh në muaj", ka thënë ministri Gashi. Ai ka thënë se Nexhmije Pagarusha gëzon respekt edhe sot nga personalitete të shumta vendore dhe ndërkombëtare. Sipas Gashit, veprat e mira nuk kanë çmim, por kultivuesit meritojnë mbështetje.

Rritet kufiri i vjetërsisë së automjeteve të importuara nga 10 në 15 vjet

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Anëtarët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, kanë votuar amendamentin i cili parasheh që bashkë me bartjen e pronësisë së automjetit, të bartet edhe regjistrimi i mbetur. Po ashtu, është votuar edhe rritja e kufirit të vjetërsisë së automjeteve të importuara nga 10 në 15 vjet.

Kryetari i grupit punues për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Automjete, Muharrem Nitaj, ka shprehur optimizëm se këto amendamente do ta marrin

mbështetjen edhe në seancë plenare të Kuvendit të Kosovës. Ai ka vlerësuar se votimi i sotëm korrigjon disa padrejtësi që u janë bërë qytetarëve. "Në Komisionin për Zhvillim Ekonomik është votuar që bashkë me bartjen e pronësisë së automjetit të bartet edhe regjistrimi i mbetur. Është votuar për liberalizimin e tregut të kontrolleve teknike. Kjo nënkupton që qytetarët mund ta bëjnë kontrollin teknik të automjetit në gjithë territorin e Kosovës e jo veç në komunën e caktuar, siç ka qenë deri më tani. Po ashtu,



është hequr kufizimi për certifikimin e kontrolleve të reja teknike. Dhe, së fundi, është votuar që kufiri i vjetërsisë së automjeteve të importuara të rritet nga 10 në 15 vjet. Jam i bindur se këto amendamente do ta marrin mbështetjen edhe në seancë plenare. Si kryetar i grupit punues për plotësim ndryshimin e Ligjit për Automjete, e falënderoj deputetin Mërgim Lushtaku si dhe të gjithë anëtarët e grupit për punën e bërë. Votimi i sotëm korrigjon disa padrejtësi që u janë bërë qytetarëve!", ka thënë Nitaj.

Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dërgohet në Kryesi të Kuvendit

**EPOKA E RE****A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 TETOR - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka mbajtur të martën mbledhjen në të cilën në rend dite ishte shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe

ndryshimplotësimi i Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit. Në këtë komision u vendos që të dyja këto projektligje të dërgohen në Kryesinë e Kuvendit. Sali Salihu, anëtar i këtij komisioni, ka thënë se në mbledhjen e fundit u formua grupi punues për Projektligjin për Mbrojtjen e Ambientit dhe, sipas tij, nëse një

ligj i plotëson tri kushte, duhet të votohet nga komisioni dhe të dërgohet për lexim. Ndërkaq zëvendëskryetarja e këtij komisioni, Besa Gaxherri, ka deklaruar se edhe pse janë tejet të rëndësishme këto projektligje, nuk është e gatshme të votojë. "Me keqardhje them se ne si subjekt politik jemi në

bojkot", është shprehur Gaxherri.

Kryetari i Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, Muharrem Nitaj, ka thënë se respekton vendimin e deputetes Gaxherri për të mos marrë pjesë fare në votim. Anëtar tjetër, Danush Ademi, ka

thënë se nuk është dakord me disa pika të këtij projektligji. Sipas tij, objektet fetare nuk do të duhej t'i paguajnë shpenzimet e ujit. Në fund të komisionit, anëtarja Ganimete Musliu ka propozuar që kërkesa e saj për vizitën në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" të realizohet në fillim të javës së ardhshme.

OEK-u dhe EYE synojnë thellimin e bashkëpunimit mes shkollave profesionale



PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Enhancing Youth Employment (EYE) kanë organizuar të martën takim të parë me biznese pas marrëveshjes së bashkëpunimit që është nënshkruar nga të dyja palët. Në këtë takim ishin të pranishëm kompani nga sektorë të ndryshëm, të cilat kishin mundësi të njoftohen nga afër

me qëllimet dhe misionin e projektit EYE, veçanërisht për projektin mbi arsimin dual si dhe t'i adresojnë problemet të cilat hasin në gjetjen e fuqisë punëtore të kualifikuar në përputhje të nevojave të tregut. "Një ndër barrierat kryesore të sektorit privat në Kosovë është mungesa e aftësisë profesionale të fuqisë punëtore, prandaj qëllimi kryesor

i projektit EYE në bashkëpunim me OEK është ta thellojë bashkëpunimin në mes të shkollave profesionale dhe sektorit privat që të ketë ndikim në rritjen e punësimit dhe ngritjen e aftësisë të duhur profesional në funksion të zhvillimit ekonomik në vendin tonë", është bërë me dije në komunikatën për medie të Odës Ekonomike të Kosovës.



Kryeministri: Lluka, një nga tatimpaguesit më të mëdhenj në Kosovë

PRISHTINË, 2 TETOR (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj ka pritur të martën në takim sipërmarrësin e mirënjohur Ekrem Lluka. Ai ka thënë se Lluka është një nga tatimpaguesit dhe punëdhënësit më të mëdhenj në Kosovë. Kryeministri ka bërë me dije se me Llukën kanë biseduar për sfidat me të cilat

ballafaqohet biznesi në vendin tonë. "Suksesi i secilit në fushën e biznesit është parakusht për zhvillimin e gjithëmbarshëm ekonomik dhe social të vendit tonë. Qeveria në vazhdimësi po krijon lehtësira për të bërë biznes si mundësi për krijimin e vendeve të reja të punës", ka shkruar kryeministri Haradinaj.

Gashi kërkon gjithëpërfshirje për hartimin e projektligjit për diasporën

Ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka bërë thirrje për angazhim më të madh të institucioneve për hartimin e një projektligji sa më gjithëpërfshirës për diasporën, ndërkaq ka treguar se arsyet themelore për hartimin e tij janë: definimi i statusit të qendrave kulturore, mënyra e komunikimit me diasporën, përfshirja e të rinjve nga diaspora, orientimi i remitencave nga diaspora, mbledhja e të dhënave të pjesëtarëve të diasporës, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me ta



EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 2 TETOR - Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, i kryesuar nga kryetarja e komisionit, Vjosa Osmani, ka mbajtur të martën një takim konsultativ me ministrin e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, në të cilin është diskutuar lidhur me Ligjin për Diasporën. Me këtë rast, ministri Gashi vuri në dukje angazhimet e ministrisë për hartimin e një projektligji sa më gjithëpërfshirës për diasporën, ndërkaq ka treguar se arsyet themelore për hartimin e tij janë: definimi i statusit të qendrave kulturore, mënyra e komunikimit me diasporën, përfshirja e të rinjve nga diaspora, orientimi i remitencave

nga diaspora, mbledhja e të dhënave të pjesëtarëve të diasporës si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me ta.

Ministri me këtë rast vlerësoi se për t'i arritur objektivat e këtij projektligji është i nevojshëm një bashkëpunim i ngushtë me komisionin dhe vlerësoi se gjatë kësaj faze konsultimet ndërmjet ministrisë, komisionit dhe diasporës duhet të ndodhin jashtë vendit, aty ku diaspora është duke jetuar. Gjatë këtij takimi ministri Gashi ka qartësuar edhe qëndrimin e ministrisë lidhur me kanalin televiziv për diasporën.

Lidhur me këtë, ai ka bërë me dije se Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike synon që ky kanal të hapet në kuadër të televizioneve publike në Shqipëri dhe në Kosovë, ndërkaq vlerësoi se kostoja

financiare për editimin e këtij programi do të ishte e përbalueshme për të dyja mediumet, TVSh-në dhe RTK-në. "Për të krijuar një ligj gjithëpërfshirës dhe adekuat propozimi ynë është të kemi debate publike të përbashkëta në diasporë që ta diskutojmë draftligjin", ka thënë Gashi, duke shtuar se do të ishte mirë që ligji të përfundonte këtë vit. "Sa iu përket shpenzimeve të udhëtimit, ne kemi menduar që ky buxhet të merret edhe nga buxheti i Ministrisë së Diasporës. Ideja

është që të bëhen dy debate, një për ligjin dhe pjesëmarrjen e diasporës në institucionet e vendit", ka deklaruar Gashi. Anëtarët e komisionit, pasi që shpalosën opinionet e tyre lidhur me punën e gjertanishme të ministrisë lidhur me këtë projektligj, u shprehën të gatshëm për një bashkëpunim të ngushtë deri në miratimin final të ligjit.

Deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacolli, ka thënë se krijimi i qendrave kulturore nga Qeveria krijon

mundësinë për ndërhyrje politike. Ndërkaq deputeti i Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka thënë se diaspora duhet të jetë më aktive në skenën politike në vend.

Ministri Gashi ka folur edhe për kartonin gjelbër dhe sa i përket votimit. Ai ka thënë se diaspora është jashtëzakonisht e diskriminuar sa i përket votimit. "Qytetarët që i kemi jashtë duhet të kenë të drejtën e votës. Shteti i Kosovës nuk është duke e trajtuar diasporën ashtu siç duhet", ka deklaruar ai.

MPMS-ja rrit përkrahjen për punësim të personave me aftësi të kufizuara

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, MË 2 TETOR - Qeveria e Kosovës i ka dhënë të martën dritën jeshile iniciativës ligjore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) që ka për synim krijimin e lehtësirave sa i përket punësueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara si për këtë kategori, po ashtu edhe për punëdhënësit e tyre.

Në mbledhjen e Qeverisë u miratua projekt-rregullorja për lehtësirat tatimore dhe doganore për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara dhe për personat me aftësi të kufizuara që ushtrojnë veprimtari të pavarur, e cila u paraqit nga ministri i MPMS-së, Skender Reçica. Para hartimit të kësaj projekt-rregullore nuk ka pasur asnjë akt juridik që rregullon këtë çështje.

Ministri Reçica ka thënë se personat me aftësi të kufizuara meritojnë trajtim të barabartë në fushën e punësimit, prandaj



Në mbledhjen e Qeverisë u miratua projekt-rregullorja për lehtësirat tatimore dhe doganore për punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara dhe për personat me aftësi të kufizuara që ushtrojnë veprimtari të pavarur, e cila u paraqit nga ministri i MPMS-së, Skender Reçica. Para hartimit të kësaj projekt-rregullore nuk ka pasur asnjë akt juridik që rregullon këtë çështje.

nëpërmjet krijimit të bazës ligjore po përpiqemi të krijojmë

sa më shumë lehtësira për këtë kategori dhe punëdhënësit

njëkohësisht. "Me miratimin e Ligjit për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional si dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara është krijuar baza ligjore për rregullimin dhe përcaktimin e lehtësirave doganore dhe tatimore të punëdhënësve që punësojnë persona me aftësi të kufizuara si dhe të personave me aftësi të kufizuara që ushtrojnë veprimtari të pavarur", ka thënë Reçica.

Në bazë të projekt-rregullores së miratuar sot në Qeveri, punëdhënësi i cili punëson persona me aftësi të kufizuara si dhe personi me aftësi të kufizuara që ushtrojnë veprimtari të pavarur kanë të drejtë për lehtësime doganore dhe tatimore të cilën e realizojnë sipas legjislacionit në fuqi dhe lehtësira specifike tatimore që nënkupton se të gjithë punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara janë të liruar nga tatimi në të ardhura personale sipas legjislacionit në fuqi për të ardhurat personale.

Hoxha zgjedhet kryetar i Parlamentit Studentor në Universitetin 'Fehmi Agani'

GJAKOVË, 2 TETOR (ER) - Në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani" u zgjodhën strukturat e reja të përfaqësimit të studentëve në Parlamentin dhe Këshilla Studentore. Më 1 tetor 2018 fillon mandati për kryetar të rinj, ai i Parlamentit Studentor, Këshillit Studentor i Fakultetit të Edukimit, Këshillit Studentor të Fakultetit të Filologjisë dhe Senatorit.

Në bazë të marrëveshjes së organizatave studentore u zgjodhën strukturat me përbërje të re të organeve të përfaqësimit studentor: Argnis Hoxha, student i Fakultetit të

Edukimit, u zgjodh kryetar i Parlamentit Studentor në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani".

Shkelqesa Mulaj u zgjodh kryetare e Këshillit Studentor në Fakultetin e Edukimit.

Diellza Mahmutaj u zgjodh kryetare e Këshillit Studentor në Fakultetin e Filologjisë, ndërsa Luan Gjuga u zgjodh senator. "Duke shpresuar që studentët të jenë krahu i djathtë i përfaqësuesve të tyre në organet e universitetit, për t'i mbrojtur të drejtat dhe luftimin e dukurive negative,



askush më shumë se studentët dhe askush më shumë se përfaqë-

suesit e tyre s'mund të bëjnë për realizimin e të drejtave që ata

kërkojnë", është bërë me dije në komunikatën për media.

Kërkohet përkushtim maksimal në punë nga drejtorët komunalë të Mitrovicës

MITROVICË, 2 TETOR (ER) - Bordi i Drejtorëve i Komunës së Mitrovicës ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës, e cila është drejtuar nga nënkryetari i Komunës së Mitrovicës, Faruk Mujka. Në këtë mbledhje janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje të rëndësishme nga fushëveprimi i bordit dhe drejtorive komunale.

Drejtori i Financave, Shukri Gashi, i ka njoftuar anëtarët e bordit lidhur me taksat komunale për plotësim dhe ndryshim të rregullores, me ç'rast ka kërkuar nga drejtorët, të cilët janë pjesë e kësaj rregulloreje, se propozimet e tyre lidhur me këtë rregullore t'i përfundojnë sa më parë dhe t'i dërgojnë në Drejtorinë e Financave deri më 4 tetor, në mënyrë që të kalojë më tutje te

Komiteti për Politikë dhe Financa, pastaj të procedohet për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit. Po ashtu, drejtori Gashi ka shpalosur edhe inkasimet e të hyrave vetjake për secilën nga drejtoritë, njëkohësisht u ka bërë thirrje drejtorëve ta japin përkushtimin maksimal për gjatë këtyre tre muajve në mënyrë që ta arrijë përqindjen e duhur.

Edhe drejtori për Mbrojtjen e Mjedisit, Asllan Isufi, ka njoftuar të pranishmit se është duke u bërë një punë e mirë për pastrimin e Liqenit Akumulues në kuadër të aksionit "Ta pastrojmë Kosovën". Ai ka kërkuar që edhe grupet e tjera vullnetare t'i bashkëngjiten këtij aksioni në mënyrë që qyteti i Mitrovicës të jetë shembull sa i përket pastërtisë.



Prokuroria e Prizrenit sekuestron 229 mijë euro

PRIZREN, 2 TETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren, në bazë të informacioneve dhe dëshmi të arsyeshme, si dhe në bashkëpunim dhe koordinim me Policinë e Kosovës, kanë realizuar bastisje në një lokacion, përkatësisht shtëpi banimi në rrugën "Rrustë Kabashi" në Prizren. Prokuroria ka njoftuar se bastisja është realizuar në bazë

të urdhërësës së lëshuar nga Gjykata Themelore në Prizren, me ç'rast si rezultat i bastisjes janë gjetur dhe sekuestruar 229 000 euro kartëmonedha parash, për të cilat ekziston dyshimi i bazuar se janë para të falsifikuara. Personat e dyshuar janë arrestuar dhe procedura ndaj tyre do të vazhdojë për hetime të mëtejshme.



Latifi vizitoi punimet për ndërtimin e ndriçimit publik në fshatin Xërxë

RAHOVEC, 2 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i shoqëruar edhe nga Përparim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike, kanë vizituar punimet të cilat janë duke u realizuar në ndërtimin e ndriçimit publik në fshatin Xërxë. Kryetari Latifi ka thënë se kanë vendosur me prioritet të lartë këtë vendbanim ku

tashmë po zbatohet në praktikë edhe një premtim të dhënë për Xërxën, sipas të cilit, do të ketë ndriçim publik brenda mandatit të tij. "Po e kryejmë këtë punë në vitin e parë të qeverisjes", ka thënë Latifi, duke shtuar se filluan me Xërxën dhe do ta vazhdojnë ndriçimin publik edhe në vendbanime të tjera të komunës.

Shtypi shqip i Kosovës për protestat studentore të 1 tetorit 1997

IZET ABDYLI

Protestat studentore të 1 tetorit 1997 të studentëve të Universitetit të Prishtinës shënojnë një nga ngjarjet më të rëndësishme të lëvizjes studentore në historinë më të re të Kosovës në fundshekullin XX. Këto ngjarje që erdhën si rezultat i aparteidit të regjimit serb mbi arsimin shqip janë pasqyruar edhe në shtypin shqiptar të kohës me një saktësi informacioni nga burime të drejtpërdrejta nga organizatori, në këtë rast Unioni i Pavarur Studentor i Universitetit të Prishtinës e në koordinim të vazhdueshëm dhe bashkorganizim edhe me pjesën akademike, përkatësisht Rektoratin e Universitetit të Prishtinës. Këto ngjarje, përveç që ishin një zë proteste ndaj diskriminimit të shqiptarëve nga regjimi serb në fushën e arsimit, luajtën edhe një rol të rëndësishëm për faktorizimin ndërkombëtar të çështjes së Kosovës.

Përgatitja e protestës, skema e organizimit të protestës dhe itinerari i zhvillimit të saj

Lidhur me përgatitjen e protestës, organizimin dhe përgatitjen e saj ekzistojnë informacione të shumta që shtypi shqiptar i Kosovës i ka plasuar qoftë nga burime të drejtpërdrejta nga konferencat e organizuara nga Unioni Studentor i Kosovës, qoftë nga kumtesat zyrtare të këtij unioni apo edhe përmes intervistave të zhvilluara me liderin e këtij Unioni, Bujar Dugolli apo edhe me kreun e pjesës akademike, rektorin Ejup Statovci. Gazetat "Bujku" dhe "Koha ditore", në artikujt e datës 26 nëntor 1997, paraqesin konferencën për shtyp të UPS të UP-së, me titujt "Protestat fillojnë më 1 tetor", "përkatësisht "Më 1 tetor fillojnë protestat studentore". Aty njoftohet se protestat studentore do të bëhen në të gjitha qytetet e Republikës së Kosovës ku janë fakultete dhe shkollat e larta. Po ashtu, thuhet se "u njoftuan 30 ambasada dhe 40 asociacione të tjera ndërkombëtare". Në faqen dy të gazetës "Bujku" jepen edhe detaje për 33 parulla të shkruara në gjuhën shqipe dhe angleze që do të përdoren ditën e protestës, ndërsa në letrën dërguar përfaqësuesve ndërkombëtarë jepen shifra rrëqethëse për ndërhyrjen brutale të regjimit serb në institucionet arsimore si rrjedhojë e së cilës nga objektet e Universitetit të Prishtinës u dëbuan mbi një mijë mësimit-hënës, rreth 200 punëtorë administrativë e rreth 27 mijë studentë. Vendosmëria e studentëve për organizimin e protestave shihet edhe në një intervistë më të zgjeruar në dy faqe të gazetës studentore "Bota e re" të Bujar Dugollit, kryetar i UPS të UP-së, ku thuhet se "nuk do të protestojmë sa për sy e faqe". Ai shpalos edhe një pjesë të plan-projektit të ndarë në katër faza, i cili më vonë do të jetë shtet nga Këshilli

Organizativ i protestës i cili bën apel që protesta të zhvillohet në mënyrë paqësore, duke shfaqur edhe drojën për eskalim të dhunës nga policia serbe me ç'rast ai fton që në rast të tillë, protestës duhet t'i bashkëngjiten edhe nxënësit. Për ndihmë konkrete ai fton edhe strukturat politike dhe jopolitike.

Kërkesa për një bashkërendim të protestës edhe me faktorin politik pasqyrohet edhe në gazetën e datës 27 shtator 1997, përmes titujve "Rugova për protestat", "Kërkoj të pritët edhe pak" dhe deklaratën e Bujar Dugollit se: "Ne për nismën tonë kemi biseduar dhe kemi siguruar përkrahjen e të gjitha subjekteve politike e jopolitike, duke përfshirë edhe presidentin e Republikës së Kosovës, z. Ibrahim Rugovën".

Se protestat kishin mbështetje edhe nga faktori ndërkombëtar tregon edhe takimi i emisarit special të ShBA-së, Robert Gelbart, ku morën pjesë: Driton Lajçi, nënkryetar i UPS-së, Fehmi Agani, nënkryetar i LDK-së, Adem Demaçi, kryetar i PPK-së, Mahmut Bakalli, politolog dhe Veton Surroi, kryeredaktor i gazetës "Koha ditore", e që në titullin e gazetës "Bota e re" të 25 shtatorit 1997 është dhënë titulli "Gelbart: Protestat paqësore janë plotësisht të pranueshme". Vendosmërinë dhe të drejtën e studentëve për organizimin e protestës më 1 tetor e mbështeti fuqishëm edhe rektori i Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovci, në një intervistë me titull "Protesta janë të studentëve", publikuar në "Kohën ditore" të datës 29 shtator 1997. Po këtë ditë jepet njoftimi i takimit të UPS me presidentin Rugovën "Vendimtar, takimi i sotëm Rugovë-studentët".

Një ditë para fillimit të protestës, në faqet e shtypit dhe ballinat e tyre temë kryesore është protesta e 1 tetorit e cila është vendosur të mbahet. Gazeta "Bujku" jep këta tituj: "Biseda me kryetarin Rugovë ishte pozitive", "Bashkësia ndërkombëtare përqendrohet në Kosovë", "Lajmi i fundit: Protestat fillojnë më 1 tetor", "Cilat janë transparentet?", "Respektojmë të drejtën për protestë paqësore" (Nga konferenca për shtyp e diplomatëve të ShBA-së, Kanadasë e disa vendeve evropiane në Prishtinë), "Kryetari përkrahu konceptin e protestave"



(deklaratë e Bujar Dugollit, kryetar i UPS të UP-së, pas takimit me presidentin Rugovën). Ndërkaq në "Kohën ditore" dominojnë titujt: "Ekskluzive: Si do të protestohet në Prishtinë më 1 tetor", "Misioni diplomatik kundër datës, jo kundër protestave. Studentët", "Vetëm një, datë 1 tetori", "Protestat studentore fillojnë nesër më 1 tetor", "Nisja nga Velania në orën 10.30 minuta", "Presidenti nuk pati asgjë kundër protestës së 1 tetorit", "Protestat fillojnë sipas planit", "Parullat dhe transparentët". Përmes këtyre titujve mund të kuptojmë se kërkesa e studentëve për protesta vlerësohej nga të gjithë si një e drejtë e pakontestueshme, pavarësisht prej kërkesave dhe shqetësimeve të përfaqësuesve diplomatikë për mundësinë e eskalimit të dhunës.

Edhe shtypi i datës 1 tetor temë qendrore ka protestën e 1 tetorit. "Bota e re" jep intervistën në dy faqe të rektorit të UP-së, Ejup Statovci, me titull "Studentët janë të Universitetit dhe Universiteti sipas qenies dhe natyrës është me studentët e vet". Ndërkaq "Koha ditore" ka këta tituj: "Tirana njofton: Studentët kosovarë duhet të protestojnë për arsimin shqip në Kosovë", "Pranvera e 1 tetorit", "Antiç: I përkrahim protestat e studentëve shqiptarë", "Protestat e 1 tetorit, paqësore, jo të dhunshme dhe studentore", "Fjetja dhe ushqimi falas për vëzhguesit e huaj".

Dita e mbajtjes së protestës, jehona e saj në opinionin vendor dhe ndërkombëtar dhe ndërhyrja brutale e regjimit serb për shtypjen e saj

Jehona e mbajtjes së protestës së 1 tetorit përfshiu jo vetëm ballinat e gazetave ditore të datës 2 tetor, por gati 50 për qind të faqeve të gazetave, duke pasqyruar në detaje rrjedhën e protestës e cila u shtyp në mënyrën më brutale me ndërhyrjen e forcave policore të regjimit serb. Ekipet të tjera të gazetave të angazhuar japin detaje për fillimin e protestës, transparentet, ndërhyrjen brutale, lëndimin e protestuesve, arrestimin nga policia e detaje të hollësishme për protestën studentore. Gazeta "Bujku" ka titullin kryesor "Protestat paqësore u përballën me brutalitetin policor", "Policia intervenoi pa paralajmërim", "Lotsjellës edhe nga helikopteri", "ShBA-të dënojnë përdorimin e dhunës në

Kosovë", "Kryetari Rugovë dënoi ashpër brutalitetin policor mbi protestuesit", "Qeveria shqiptare dënon dhunën mbi shqiptarët", "Bukoshi: Nuk na praps vringëllima e armatimit serb", "Qetësia jonë tmerroi policinë" (Deklaratë e rektorit Statovci pas lirimimit nga arresti), "Ambasada Amerikane e brengosur për situatën e krijuar", "Në gjithë qytetin intervenime pa shkas", "Dhunë e shfrenuar kundër protestuesve shqiptarë", "Dr. Zekeria Cana: Ditë e shenjtë historike", "Intervenimi i policisë edhe në Kodrën e Diellit", "Qindra policë para Radio Prishtinës", "Demonstratat nuk ndërpritën, format do të ndryshojnë", "U trajtuan afër 60 të plagosur", "U rrahën brutalisht disa gazetarë të Rilindjes", "E tërë Prishtina spital", "Përleshje në Kodrën e Trimave", "Policët me shkopinj mbi studentët", "Taksistët ndihmojnë studentët", "Snajperët dhe Pazari i vdekur (janë dy poezi të Ali Podrimjes)", "Engëll kërkon që SHBA-të të dënojnë energjikisht Serbinë". Nga këta tituj mund të shihet se pasqyrimi i protestës nga ekipi i gazetave të "Bujkut" ka përfshirë të gjitha segmentet e protestës që nga fillimi i saj, ndërhyrja brutale, arrestimi i demonstruesve, dërgimi në spitale, dhuna ndaj gazetarëve, ndërhyrjet nëpër rrugë të tjera të qytetit, bllokimi i rrugëve etj. Pothuajse ngjashëm ka raportuar edhe gazeta "Koha ditore" e cila ka angazhuar një ekip të tërë të gazetave të cilët përmes raportimeve nga vendi i ngjarjes edhe me fotografi kanë dhënë pamje të trishtuara të dhunës policore mbi studentët dhe qytetarët e tjerë që kanë mbështetur protestën. Këta janë tituj kryesorë: "Nuk jemi frikësuar", intervistë me Albin Kurtin, "Studentët mbajtën fjalën", "Arrestimi te Velania", ku flitet për arrestimin e rektorit Statovci, prorektorit Ahmet Gjoca, Bujar Dugollit, kryetar i UPS dhe anëtarëve të Kryesisë së UPS, Albin Kurti, Driton Lajçi dhe Lulzim Jagxhiu, "Dr. Maxhuni: Dugolli e Lajçi ishin rrahur së tepërmi", "Millosheviqi fajtor për përdorimin e dhunës", "BE-ja dhe ShBA-ja dënojnë aksionin e policisë në Kosovë", "Ballë për ballë me policinë", "Demaçi akuzon qeverinë serbe për shkelje premtimi", "Kurti: Studentët nuk janë frikësuar", vlen të përmendet se kjo

gazetë jep informacione të hollësishme pothuajse nga çdo pjesë e Prishtinës, si: Te udhëkryqi i Taslixhës, te Tregu i Gjelbër, te Klinika "Nënë Tereza", te Gjimnazi "Xhevdet Doda", te Filologjiku, te ish-Kuvendi i Kosovës, te Shkolla e Mesme Teknike, te Qafa, te Shkolla Filllore "Gjergj Fishta" etj.

Opinionet pas mbajtjes së protestës, analizat dhe rezultatet e saj

Jehona e protestës u pasqyrua në shtypin ditore edhe në opinionet pro et contra, duke nxjerr analizë e përfundime për efektin e protestës, masivitetin e saj dhe organizimin e saj në një nivel të lartë. Po ashtu, u pasqyruan edhe gjurmët e dhunës dhe pasojat e saj. Titujt që dominojnë në gazetën "Bujku" ishin: "Kudo gjurmë të dhunës", "Trajtim barbar që duhet ndëshkuar", "Të dënohet edhe më ashpër regjimi serb", thuhet nga tridhjetë e dy kongresistë amerikanë që dënojnë masat e Beogradit ndaj protestuesve. "Protestat arritën efektin e tyre", "Kosova për Serbinë është e humbur", "Tirana kërkon ndërhyrjen e komunitetit ndërkombëtar", "Përkrahje e fuqishme pjesëmarrësve të protestës". Në përgjithësi jepen informacione dhe qëndrime të asociacioneve vendore e ndërkombëtare të cilat dënojnë dhunën e shfrenuar ndaj protestuesve të qetë dhe kërkojnë ndaljen e këtij represioni mbi shqiptarët.

Vëmendje "Koha ditore" i kushton edhe pasqyrimin të protestës nga reporterët e huaj, përmes artikullit "Velaninë e kaploi qetësia e vdekjes", ku reporterët e huaj për gazetën dhe mediat e tyre raportojnë për gjendjen e rëndë dhe shtettrrethimin e forcave policore serbe në qytetin e Prishtinës. Vlen të përmenden "Asosiated Press", "Evropa e lirë", "Zëri Amerikës" etj. Po ashtu, vëmendje u kushtohet edhe reagimeve të misioneve diplomatike dhe personaliteve me ndikim në politikën amerikane dhe evropiane.

Përmasa, dimensionin dhe hapësirën që i është dhënë kësaj proteste në shtypin e kohës është vetëm një shtyp argumenteve që shërbejnë për një paraqitje sa më reale, duke marrë parasysh distancën kohore prej 21 vjetëve qëkur është zhvilluar kjo ngjarje e cila do të zë vend me rëndësi në historinë më të re të Kosovës. Kundrimi i kësaj ngjarje nga shtypi vendor mbase nuk mund të japë një pasqyrë krejtësisht të plotë rreth ecurive të përgatitjes, zhvillimit dhe rezultateve të protestës, nëse nuk bëhen krahasime edhe me shtypin e huaj dhe mediat e tjera elektronike të informimit por, megjithatë, është një bazë e mirë për hulumtimet e mëtejme të atyre që do të merren me trajtimin e kësaj teme.

(Autori ka mbaruar studimet master për Arkivistikë)

Britania mund të dalë nga BE-ja edhe pa marrëveshje

LONDËR, 2 TETOR - Britania mund të dalë nga BE-ja pa një marrëveshje me Bashkimin Evropian. Sipas ministrit britanik për "Brexit", Dominic Raab, kërkesat e BE-së

janë të ekzagjeruara. "Gatishmëria jonë për kompromis nuk është e pakufishme. Ne nuk do ta kërkojmë shtyrjen e zbatimit të nenit 50. Nëse oferta e vetme e BE-së kër-

cënon unionin tonë, atëherë nuk na mbetet rrugë tjetër, veçse të dalim pa marrëveshje", theksoi Raab. Sipas Raabe, BE-ja kërkon ta mbajë vendin në union përmes

trukeve. Edhe ministri britanik i Tregtisë paralajmëroi Bashkimin Evropian, duke thënë se mungesa e marrëveshjes do ta dëmtojë shumë edhe tregtinë e BE-së.



Trumpi ia përkeqëson imazhin Amerikës

Studimi i Qendrës së Kërkimeve Pew tregoi se imazhi i Amerikës, i cili pësoi një goditje të madhe më 2017, vitin e parë të Trumpit në detyrë, vazhdoi të përkeqësohet në shumë vende në vitin 2018, veçanërisht në Evropë. Ndërkaq kancelarja gjermane Angela Merkel është udhëheqësja më e besueshme në botë, me 52 % mbështetje - pothuajse dy herë më shumë sesa Trumpi

WASHINGTON, 2 TETOR - Imazhi i Shteteve të Bashkuara në botë ra më shumë këtë vit, pasi presidenti Donald Trump i sulmoi aleatët dhe i lavdëroi armiqët, thuhet në një studim të Qendrës Amerikane të Kërkimeve Pew. Sipas saj, njerëzit në shumicën e vendeve u besojnë jo vetëm udhëheqësve të Gjermanisë dhe të Francës, por edhe të Rusisë dhe të Kinës më shumë sesa Trumpit.

Anketa me 26 112 njerëz në 25 vende të Qendrës Pew zbuloi se vetëm 27 % e tyre besojnë se Trumpi bën gjënë e duhur në çështjet botërore krahasuar me 30 % që shprehin besim të presidentit rus, Vladimir Putin, dhe 34 % të presidentit të Kinës, Xi Jinping. Kancelarja gjermane Angela Merkel është udhëheqësja më e besueshme në botë, me 52 % mbështetje - pothuajse dy herë më shumë sesa Trumpi. Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, është prapa Merkelit me një vlerësim prej 46 %.

Prejse ka marrë detyrën në janar të vitit 2017, Trumpi e ka tërhequr ShBA-në nga disa marrëveshje ndërkombëtare, të tilla si Pakti i Parisit për Klimën dhe Marrëveshja Bërthamore me Iranin, ka bërë përpjekje të krijojë marrëdhënie më të afërta me udhëheqësit autoritarë si Putini dhe lideri verikorean,

Kim Jong Un, si dhe ka kritikuar rëndë Kanadanë dhe Meksikën fqinje, ashtu si edhe Gjermaninë dhe aleatët e tjerë të NATO-s.

Në qershor, pas një samiti të G7-s, grupit të vendeve më të industrializuara, në Kanada, Trumpi ka refuzuar të nënshkruajë një deklaratë të përbashkët me aleatët amerikanë, duke e nënçmuar nikoqirin e tij, kryeministrin kanadez Justin Trudeau, si "shumë të panderëshëm dhe të dobët". Trumpi e ka kritikuar Gjermaninë për suficitin e saj tregtar, shpenzimet e vogla në mbrojtje dhe mbështetjen në gazin rus.

Javën e kaluar, gjatë fjalimit në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, ai ka shkaktuar të qeshura në audiencë kur ka thënë se, gjatë dy vjetëve në Shtëpinë e Bardhë ka arritur më shumë se gati çdo administratë tjetër amerikane.

Studimi i Qendrës Pew tregoi se imazhi i Amerikës, i cili pësoi një goditje të madhe më 2017, vitin e parë të Trumpit në detyrë, vazhdoi të përkeqësohet në shumë vende në vitin 2018, veçanërisht në Evropë.

Vetëm 30 % e gjermanëve kanë një pikëpamje të favorshme për Shtetet e Bashkuara, 4 % më pak sesa vitin e kaluar. Rënie ka edhe në Francë dhe në Kanada, ku mbështetja qëndron në 38



% përkatësisht 39 %. Vendet me pikëpamjet më pozitive për Shtetet e Bashkuara janë Izraeli, Filipinet dhe Koreja e Jugut, të gjitha me 80 % ose më lart.

Brenda ShBA-së, ndërkaq, mbështetja është rritur në 50 %, krahasuar me 43 % sa ka qenë vitin e kaluar. Pavarësisht prej vlerësimeve të ulëta për

Trumpin, 63 % e të anketuarve thanë se bota ka qenë më e mirë me ShBA-në si fuqi udhëheqëse, krahasuar me 19 % që e preferuan Kinën në këtë rol.

ShBA-ja paralajmëron Rusinë për programin e raketave

BRUKSEL, 2 TETOR - Ambasadorja amerikane në NATO tha se Rusia duhet ta ndalë zhvillimin e fshehtë të një sistemi të ndaluar raketash, përndryshe Shtetet e Bashkuara do të përpiqen ta shkatërrojnë atë përpara se të vihet në veprim. Shtetet e Bashkuara besojnë se

Moska po zhvillon një sistem raketash që lëshohen nga toka, i cili mund ta lejojë Rusinë të ndërmarrë një goditje të shpejtë bërthamore ndaj Evropës. Sistemi do të ishte në kundërshtim me një traktat të periudhës së Luftës së Ftohtë, por Rusia vazhdimisht ka mohuar se po

bën ndonjë shkelje të tillë. Ambasadorja amerikane Kay Bailey Hutchison tha se ShBA-ja është për një zgjidhje diplomatike të çështjes, por është e përgatitur të shqyrtojë një goditje ushtarake nëse Rusia vazhdon zhvillimin e sistemit të raketave me reze të mesme veprimi.

Gjermania ndryshon ligjin, kërkon emigrantë

BERLIN, 2 TETOR - Koalicioni qeverisës në Gjermani është pajtuar për një ligj të ri të imigrimit, ashtu që të pranojë më shumë punëtorë që plotësojnë kushtet për punë nga vendet jashtë Bashkimit Evropian, duke shpresuar në përmbushjen e vendeve të punës dhe stabilizimin e sistemit pensional, transmeton "Reuters". Meqë fuqia punëtoare e

Gjermanisë pritet të zvogëlohet në dekadat e ardhshme, për shkak të vjetërsimit të popullatës dhe uljes së numrit të lindjeve, migrantët janë duke u konsideruar shumë të rëndësishëm për t'u ndihmuar kompanive në këtë shtet.

Mirëpo ligji i ri për migrantët, për të cilin janë pajtuar partia e kancelares gjermane, Angela

Merkel, ministri i Brendshëm, Horst Seehofer dhe ministri socialdemokrat i Punës, Hubertus Heil, rrezikon t'i rrisë tensionet e votuesve, në mesin e të cilëve edhe tani ka persona që ndihen të neglizhuar për shkak të pranimit të më shumë se një milion refugjatëve më 2015.

Fluksi i pashembullt i azilkërkuësve, kryesisht nga

shtetet myslimane të Lindjes së Mesme, ka shkaktuar pakënaqësi në Gjermani dhe ka rritur përkrahjen për partinë e të djathtës ekstreme, Alternativa për Gjermaninë.

Seehofer ka thënë se marrëveshja e arritur në bazë kompromisi do t'i largojë pengesat për punësim sa iu përket qytetarëve që nuk u takojnë vendeve të BE-së dhe të



cilët janë të kualifikuar, por edhe kanë njohuri të gjuhës gjermane. "Vazhdojmë ta përkrahim parimin e ndarjes së azilit dhe migrimit për punë", ka thënë Seehoferi në një konferencë me gazetarë.



OFERTË PËR SHITJE TË SHTËPISË

Shitet shtëpia dykatëshe, me sipërfaqe prej 218 m², dhe trualli me sipërfaqe prej 410 m².

Shtëpia gjendet në Prishtinë, në lagjen "Aktash I", rr. "Ferhat Draga" nr. 1.

Procedura e transaksionit nga shitësi te blerësi bëhet pas nënshkrimit të kontratës së shitblerjes dhe pagesës së çmimit të kontraktuar, pastaj paluejtshmëria e përshkruar më lart kalon te blerësi.

Çmimi sipas marrëveshjes.

**Informata më të hollësishme
mund të merren në numrin e telefonit
001-347-331-8305 në Nju Jork, kurse në Prishtinë
në celularin 044-166-580.**

Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbrypa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

AUTOSHKOLLA "RITMO - L"



**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

E frikshme, i riu bën akrobaci në lartësinë 270 metra

Një i ri ka rrezikuar jetën e tij duke bërë akrobaci në majën e një ndërtese 270 metra të gjatë në Emiratet e Bashkuara Arabe. Nikita Deft, nga Rusia, pa frikë qëndroi në cep të ndërtesës duke u hedhur me litar, ndërsa shikuesit mbeten të frikësuar nga marifetet e rrezikshme.



FOTO E DITES



Fëmijët e shkollave indiane të veshur si Mahatma Gandhi. /AFP/

E rrallë

Restorantet në Angli, bakshishet për stafin me ligj

Restoranteve në Angli do t'u ndalohet me ligj mbajtja e bakshisheve të siguruar prej stafit. Rrjete të njohura atje, si "Prezzo", "Strada" dhe "Zizzi", do të detyrohen t'ua kalojnë punonjësve të gjithë çfarë përfitohet në këtë mënyrë. Masa



vjen si pasojë e indinjatës publike, që solli praktika e disa restoranteve të famshme në vend për t'ua kaluar bakshishet pronarëve, e jo stafit.

BARSOLETA E DITËS



Bajrami: Pse e le punën në varreza? Avdia: E lashë sepse të gjithë rrinin shtrirë, dhe vetëm unë punoja!



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

Rolet: Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

Regjia: Genndy Tartakovsky



Në ora 18:00

"THE DARKEST MINDS"

Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

Rolet: Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

Regjia: Jennifer Yuh Nelson



Në ora 20:00 dhe 22:00

"THE PREDATOR" 3D,

Aksion/Aventure/Horror; 1 orë 47 min

Rolet: Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilara, Jake Busey, etj.

Regjia: Shane Black



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Jeni shumë të hapur dhe prisni që dhe të tjerët të kenë të njëjtën sjellje karshi jush. Harroni që njerëzit janë të ndryshëm.



DEMI

Persona që i mendoni të afërt nuk ju janë gjendur pranë në çastet tuaja më të vështira. Sot do t'ua thoni përballë këtë gjë.



BINJAKËT

Gjatë ditës së sotme do t'ju lindin mundësi të reja që do të jenë shumë fitimprurëse dhe mjaft argëtuese. Do të pranoni çdo sfidë.



GAFORRJA

Sot doni të çlodheni dhe mënyra e vetme është një aktivitet artistik ose takimi me njerëz të mirë dhe që ju kuptojnë.



LUANI

Sot do të përballeni me një person që ka hapur një keqkuptim të madh midis jush dhe kolegëve tuaj. Masat që do të merrni do të jenë drastike.



VI RGJËR ESHA

Po merrni vendime jo shumë popullore. Do të ndikoni në distancën që do të krijohet mes jush dhe miqve tuaj.



PESHORJA

Kërkoni gjatë gjithë kohës që t'ju mirëkuptojnë, por kjo kërkesë e vazhdueshme mund të ketë efekte negative dhe mund të mos arrini asgjë.



AKREPI

Keni pasur gjithë kohës suportin e familjarëve tuaj në çështje të ndryshme. Duhet të filloni të mësoni të ecni vetë me këmbët tuaja.



SHIGJETARI

Duhet të mësoni t'i bëni gjërat hap pas hapi dhe do të shikoni që do të arrini të zgjidhni gjithçka. Plane të reja për një vend të ri pune.



BRICJAPI

Projektet personale do të jenë ato që kanë precedencën sot. Do të arrini të zgjidhni një mosmarrëveshje në ambientin tuaj të punës.



UJORI

Një person që për ju është i veçantë do t'ju zbulojë një anë aspak të mirë të karakterit të tij. Nuk do të dini se si të veproni në të ardhmen.



PESHQIT

Sot keni një ndjesi që nuk do të arrini t'i përfundoni të gjitha gjërat që keni marrë përsipër. Kërkoni ndihmë nëse e shihni të nevojshme.

Kim Kardashiani tregon kur del albumi i ri i Kanye Westit



Kim Kardashiani ka zbuluar datën e lëshimit të albumit të ardhshëm të burrit të saj, Kanye West, me titull "Yandhi". Nëse nuk e dini, Kanye fillimisht ka premtuar se albumi i tij i nëntë do të dalë

në natën kur performoi në Night Live Sunday, gjë që nuk ndodhi. Tani Kimi hyri në "Twitter" për të sqaruar kur do të dalë ky album. "23 nëntor. 'Yandhi', më besoni, ia vlen pritja", ka shkruar Kimi.

Ku e kaluan fundjavën Justini dhe Hailey?



Justin Bieber nuk ndahet nga tashmë gruaja e vet, Hailey Baldwin. Këngëtarja 24-vjeçare është parë bashkë me modeluesen duke shëtitur me një makinë të tipit Mercedes Benz SUV të hënën në Los Angeles. Një ditë më parë çifti është

parë duke hyrë në një avion privat për të marrë rrugë në Kanada. Është raportuar se çifti kaloi fundjavën në shtëpinë pesë milionë dollarëshe të familjes së Justinit, bashkë me babanë e tij, Jeremyn dhe fëmijët e tij.



Rita Ora, e para femër në kopertinën e revistës nga Lindja e Mesme

Rita Ora është bërë gruaja e parë që shfaqet në kopertinën e medias nga Lindja e Mesme, "Esquire". Këngëtarja 27-vjeçare ka zbuluar lajmin e bujshëm në profilin e vet në "Instagram", ndërkohë që ndau disa fotografi të zjarra gjatë xhirimeve për platformën e medieve sociale. Rita ndau fotografi dhe video ku pozon për platformën e medieve sociale, duke festuar një moment historik të fuqishëm.



Tyrese Gibson bëhet sërish baba

Tyrese Gibson dhe Samantha kanë mirëpritur në jetë fëmijën e tyre. Çifti ka zbuluar se vajza e tyre me emrin Soraya Lee ka lindur të hënën. Tyrese përmes "Instagram"-it ka shkruar disa fjalë. "Gruaja ime është kampione e vërtetë, 30 orë punë, unë isha dëshmitar. Faleminderit, Zot!" Tyrese është tashmë baba i 11-vjeçares Shayla nga një martesë e mëparshme.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

FC PORTO - GALATASARAY

1

NAPOLI - LIVERPOOL

GG

PSV - INTER MILAN

2

Feronikeli në 'Zahir Pajaziti' synon ta ruajë pozitën e parë

Derbi i xhiros së tetë në elitë zhvillohet sot në mes të Llapit dhe Feronikelit. Kjo e fundit është lidere dhe këtë pozitë synon ta mbajë edhe pas kësaj ndeshje. "Për ne është një ndeshje shumë e rëndësishme, pasi synim e kemi ruajtjen e pozitës së parë në tabelë. Përballë e kemi një kundërshtar shumë të fortë me lojtarë që kanë përvojë dhe, pa dyshim, kjo është ndeshja më interesante për klubin tonë deri tash. Synimi ynë është fitorja, por normalisht se do të ishim të kënaqur edhe me një barazim", ka thënë Rexha

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 TETOR - Skuadra e Feronikelit i ka bërë të gjitha përgatitjet për të mbetur në pozitën e parë edhe pas ndeshjes derbi ndaj Llapit, e cila zhvillohet sot (e mërkurë) në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë. Kastriot Rexha ka thënë të martën për "Epokën e re" se Llapi ka një ekip të mirë dhe me lojtarë që kanë përvojë të madhe, por Feronikeli në këtë ndeshje synon të dalë triumfues. "Për ne është një ndeshje shumë e rëndësishme, pasi synim e kemi ruajtjen e pozitës së parë në tabelë. Përballë e kemi një kundërshtar shumë të fortë me lojtarë që kanë përvojë dhe, pa dyshim, kjo është ndeshja më interesante për klubin tonë deri tash. Synimi ynë është fitorja, por normalisht se do të ishim të kënaqur edhe me një barazim", ka thënë Rexha, i cili ende nuk e di se a do të paraqitet në këtë ndeshje për shkak të një lëndimi. "Kam probleme me një dëmtim, por ende nuk është dhënë vendimi final nga stafi mjekësor për paraqitjen time në këtë ndeshje. Dëshira ime është të luaj dhe ta ndihmoj skuadrën në këtë derbi", ka shtuar

Rexha. Feronikeli pas shtatë xhirove zë vendin e parë me 17 pikë, kurse Llapi pozicionohet në pozitën e dytë me një pikë më pak.

Mesfushori i Llapit, Edon Zeqiri, për gazetë ka konfirmuar se skuadra e drejtuar nga Bylbyl Sokoli ka synim të madh në derbin ndaj skuadrës lidere. "Ne i kemi bërë të gjitha përgatitjet për këtë ndeshje derbi dhe synim i Llapit është fitorja, por kundërshtar e kemi skuadrën lidere dhe tri rezultatet janë të mundshme", ka deklaruar Zeqiri. Mungesa më e madhe në formacionin e Llapit për këtë ndeshje pritet të jetë Mentor Zhdrella. Krahas ndeshjes Llapi - Feronikeli, sot takohen edhe Drita - Trepça '89, Liria - Prishtina dhe KEK-u - Ballkani. Të enjten zhvillohet ndeshja e fundit për këtë xhiro në mes të Flamurtarit dhe Gjilanit.

Ferizaj, bindës ndaj Drenicës

Skuadra e Ferizajt ka arritur një rezultat të mirë në ndeshjen e xhiros së tetë në IPKO Superligë, pasi e ka mposhtur Drenicën nga Skenderaj (2-0). Pjesa e parë e ndeshjes së zhvilluar në Ferizaj u mbyll pa gola 0-0, kurse në pjesën e dytë vendësit patën më

shumë mundësi dhe arritën të shënojnë dy herë dhe ta marrin maksimumin e pikëve. Në minutën e 67 Genc Hamiti e "dënoi" ish-skuadrën e tij, duke shënuar për 1-0, kurse rezultatit final e vulosi Dren Gashi në minutën e 87.

IPKO SUPERLIGA

Ferizaj - Drenica 2-0

Të mërkurën takohen:
Llapi - Feronikeli
Drita - Trepça '89
Liria - Prishtina
KEK-u - Ballkani
Të enjten takohen:
Flamurtari - Gjilani

LIGA E PARË

Të mërkurën takohen:
Besa - Vushtrria
Vëllaznimi - Fushë Kosova
Trepça - 2 Korriku
Istogu - Bashkimi (K)
Vitia - Drenasi
Arbëria - Onix
Kika - Ramiz Sadiku
Vllaznia (P) - Dukagjini

SHKURT

Kasumi e Zeqiri në Bullgari për ndeshjet e mini-turneut UEFA-Cup

Gjyqtarët e Futbollit të Kosovës, të cilët tashmë kanë stemën e FIFA-s, gjithnjë e më shumë po angazhohen në ndeshjet dhe turnet e ndryshëm për ta ndarë drejtësinë. Gjyqtari kryesor Besfort Kasumi bashkë me asistentin e tij Edmond Zeqiri sot (e mërkurë) udhëtojnë për në Bullgari, ku do ta ndajnë drejtësinë në ndeshjet e mini-turneut UEFA-Cup për rajonet për amatorë. Kjo garë është themeluar nga UEFA në vitin 1996. Dyshja Kasumi - Zeqiri do të qëndrojnë 9 ditë në këtë turne dhe do t'i gjykojnë tri ndeshje, ku në dy sosh Besforti është kryesor dhe në ndeshjen e tretë gjyqtar i katërt.

Mazrekaj: Në janar transferohem në Norvegji

Mesfushori Mentor Mazrekaj ka thënë se deri në janar do të luajë për skuadrën e Ferizajt, kurse më pas do të transferohet në Norvegji. "Deri në janar do të luaj në Kosovë, më pas do të transferohem në Norvegji për ta vazhduar karrierën", ka thënë Mazrekaj për "VipSport.al". Futbollisti në fjalë ka luajtur një kohë të gjatë për Prishtinën, kurse karrierë ka bërë edhe në futbollin e Shqipërisë.

Osmani, trajner i Vllaznisë

Skuadra e Ligës së Parë në futboll, Vllaznia e Pozharanit, e ka emëruar trajner të ri Ali Osmanin. Ky i fundit ka qenë lojtar i KF Prishtina dhe trajner i këtij klubi, kurse nga sot do ta drejtojë skuadrën e Vllaznisë. Skuadra që vitin e kaluar bëri gara në Superligë, Vllaznia, këtë edicion e ka nisur keq dhe pas gjashtë xhirove është në vendin e fundit me vetëm një pikë.

FFK-ja dënon me dy vjet moslojë futbollistin Burhan Berjani

Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës e ka dënuar futbollistin e skuadrës së Rinisë nga Miradia, Burhan Berjani, me dy vjet moslojë për shkak të sulmit që ai bëri ndaj gjyqtarit. Ndërsa bashkëlojtari i Berjanit, Fitim Krasniqi, u dënua me gjashtë muaj suspendim, pasi u identifikua si pjesëmarrës në ndërprerjen e ndeshjes së Javës së IV-të të Ligës së Dytë të Kosovës në futboll për kategorinë e sendorëve, grupi B; Rinia - Kosova (P), e zhvilluar në Miradi të Fushë-Kosovës.

Berisha i gatshëm për Maltën dhe Ishujt Faroe

PRISHTINË, 2 TETOR - Valon Berisha do të rikthehet pas një viti te Përfaqësuesja e Kosovës në futboll. "Sport News" raporton se 25-vjeçari do të grumbullohet për dy ndeshjet e ardhshme

kundër Maltës dhe Ishujve Faroe. Mesfushori i Lazios për herë të fundit ka veshur fanellën e "Dardanëve" më 13 nëntor 2017 kundër Letonisë, miqësore të cilën Kosova e kishte fituar 4-3

në Mitrovicë. Prej se është emëruar trajner i ri Bernard Challandes, Berisha nuk është grumbulluar asnjëherë në përfaqësuese dhe gjithnjë arsyetim ka qenë lëndimi, edhe sa ishte

pjesë e Salzburgut, por edhe pasi kaloi në Itali. Sido që të jetë, tani futbollisti më i shtrenjtë i Kosovës është rikuperuar plotësisht nga lëndimi dhe po pret të debutojë me Lazion.



Sonte Tottenham - Barça dhe Napoli - Liverpool

LONDËR, 2 TETOR - Liga e Kampionëve ka rezervuar për ditën e mërkurë super duelin Tottenham - Barcelona, në "Wembley", aty ku londinezët do të provojnë t'i marrin pikët e para në grup, pas humbjes së pësuar në "San Siro", përballë Interit. Katalanasit vijjnë pas suksesit përballë PSV Eindhovenit, ndërsa duan që ta rigjejnë veten duke qenë se në tri ndeshjet e fundit në kampionat kanë barazuar dy herë dhe humbur. Gjithçka do të varet nga këmbët e tij, Lionel Messi. Sa i përket anglezëve, pritet shumë nga Harry Kane. Do të mungojë dy yjet, Eriksen dhe Delle Ali, ndaj Pochetino duhet të eksperimentojë disi. Në po të njëjtin grup, Interi në mbrëmje do të udhëtojë në Holandë, përballë skuadrës së drejtuar nga ish-milanisti Van Bommel. Në Grupin A, Atletico do të përpiqet për liderhipin, pasi përballë do të ketë modestët e Club Brugges, ndërsa Borussia Dortmundi ka një klient pak të bezdisur, si Monaco që, megjithatë, këtë sezon është në krizë, pasi ka shumë lojtarë të rinj. Në Grupin C, PSG-ja duhet thjesht ta kryejë formalitetin ndaj Crvena Zvezdas që, megjithatë, arriti ta ndalë Napolin në ndeshjen e parë. Mbappe, Cavani, Neymar dhe Chupo Moting janë gati ta bombardojnë portën e ekipit serb, raporton Telesport". Kryesfida tjetër e mbrëmjes sheh Napolin përballë Liverpoolit, në "San Paolo". Insigne, Mertens dhe Callejon do të jenë përballë treshes së frikshme Firmino, Salah dhe Mane. Në grupin D në Moskë do të jetë radha e Schalkes, ndërsa Porto e rekordmenit Iker Casillas pret turqit e Galatasarayt.



GRUPI A			GRUPI C		
21:00 Atletico Madrid-Club Brugge			18:55 PSG - Crvena Zvezda		
21:00 Borussia Dortmund-Monaco			21:00 Napoli - Liverpool		
Tabela			Tabela		
1. Atletico Madrid	1	3 pikë	1. Liverpool	1	3 pikë
2. B. Dortmund	1	3	2. Crvena Zvezda	1	1
3. Monaco	1	0	3. Napoli	1	1
4. Club Brugge	1	0	4. PSG	1	0
GRUPI B			GRUPI D		
21:00 PSV Eindhoven-Inter			18:55 Lokomotiv Moscow-Schalke 04		
21:00 Tottenham Hotspur-Barcelona			21:00 Porto-Galatasaray		
Tabela			Tabela		
1. Barcelona	1	3 pikë	1. Galatasaray	1	3 pikë
2. Inter	1	3	2. Porto	1	1
3. Tottenham H.	1	0	3. Schalke 04	1	1
4. PSV Eindhoven	1	0	4. Lokomotiv M.	1	0

Sistem i ri kualifikimi në provat zyrtare për vitin 2019

LONDËR, 2 TETOR - Departamenti menaxherial i Formulës 1 po mendon të aplikojë një sistem të ri kualifikimi të makinave gjatë provave zyrtare (ditën e shtunë), duke nisur nga viti 2019. Sipas "Autosport", në mbledhjen e fundit të bordit strategjik është diskutuar një format i ri, me katër sesione provash zyrtare, ku në çdo sesion do të eliminohen katër makina. Pra, në sesionin e katërt dhe të fundit do të qëndronin në pistë për "pole position" vetëm 8 makina dhe jo 10 siç ndodh aktualisht. Sipas



FIA-s, ky sistem i ri u pëlqen fansave të këtij sporti dhe do ta ndërlikonte jo pak kualifikimin e pilotëve dhe, para së gjithash, do ta rriste spektaklin në pistë. Ky është një propozim i

hedhur në diskutim nga vetë pronarët e rinj të Formula 1, që duan ta aplikojnë që nga viti i ardhshëm. "Ne kemi 'hetuar' mes fansave dhe i kemi pyetur dhe ata na kanë dhënë këtë sugjerim. Një zgjidhje që do t'i kënaqte ata, pasi do të kishte më shumë spektakël në pistë. Gjithsesi, një ndryshim nuk është një gabim, pasi sjell një frymë të re, edhe pse në fund do të jetë bordi drejtues ai që do ta marrë vendimin përfundimtar", ka thënë Charlie Whiting, drejtori i garave të Formulës 1.

SHKURT

De Biasi nuk shkon në Rumani, Chievo një mundësi e re

Gianni De Biasi mbetet i papunë. Së fundmi ai mori një ofertë nga Armenia, madje mediet vendëse raportuan se italiani kishte qenë atje dhe kishte biseduar me presidentin e federatës. Në fund nuk ka pasur marrëveshje. Sipas asaj që raporton "Tuttosport", De Biasi e ka refuzuar ofertën e bërë, edhe pse paga dhe bonuset që mund të përfitonte ishin goxha të mëdha. Ndërkohë emri i teknikut italian së fundmi është lakuar edhe te Frosinone. Gjithashtu, edhe te Chievo ka dalë si opsion, por nga ajo që raportojnë mediet në Itali, nuk është De Biasi kandidati kryesor.

Alison: Kam qarë kur u largova nga Roma

Portieri brazilian Alison Becker ka bërë me dije se ka qarë pas transferimit në Liverpool nga Roma. "Ta lije Romën ishte mjaft e vështirë. Kam qarë për një kohë të gjatë, së bashku me gruan time. Bëra një zgjedhje profesionale, një hap përpara në karrierën time e Roma mori, gjithashtu, shumë para. Me kokë vendosa të shkoj te Liverpooli, por zemra ime ishte mbushur me lot", ka thënë Alisoni.

De Boeri: Zaha si Messi

Ish-trajneri i Crystal Palaces dhe Interit, Frank de Boer, mendon se aftësitë dribluese të Wilfried Zahas janë të ngjashme me ato të yllit argjentinas të Barcelonës, Lionel Messi. "Ajo që Zaha e ka është një gjysmëhapi. Si mbrojtës, ti mendon se do ta prekësh topin, por ai është shumë i shpejtë, e bën një gjysmëhapi, e prek topin me këmbën tjetër. Ti mendon se e ke marrë topin, por në të vërtetë e ke goditur këmbën e tij. Ai është si Messi, gjithmonë, çdo hap dhe çdo prekje të topit që e bën, me këmbën e djathtë apo të majtë, Zaha e ka të njëjtin kualitet. Nëse luan një kundër një, ai është i jashtëzakonshëm", ka thënë De Boer.

Lehmanni: Leno do të jetë i suksesshëm në Arsenal

Legjenda e Arsenalit, Jens Lehmann, beson se Bernd Leno i ka të gjitha elementet për të qenë një portier i suksesshëm në "Emirates". Leno ka fituar vendin e titullarit tek Arsenal pas një lëndimi të Petr Cech. "Ai është një goditje e fortë, një goditje shumë e mirë. Ai është i qetë dhe është i mirë. Për të qenë i suksesshëm në Arsenal duhet të fitojë diçka", ka pohuar Lehmann.

Rebiqi konfirmon dëshirën për largim nga Frankfurti

